



Pranimi / Dorëzimi Priljezja / Priljezja Received / Delivery	06.12.2023	3	vetë që vitet
Organ / Rrjesia Org / Jednica Org / Unit	SKPMST/01	7343/2023	1/3
Titulli / Protokoll Tit / Prot Prot No			
Shtesa / Protokol Shtesa / Protokol Appendix			
Sasia Kopimet Quantity			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1334/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtare, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1334/2023 të datës 26.10.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë:

kundër Organit të punësimit Inspektorati i Punës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 06.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.1334/2022 e datës 26.10.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi, _____ i punësuar në Inspektoratin e Punës, me datë 26.10.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6697/2023 të regjistruar me numër A.nr.1334/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Inspektoratit të Punës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me pretendimin ankimor që i njëjti të kompensohet sikurse është i emëruar me aktin emërimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.10.2023 ka

proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Inspektorati i Punës, ndërsa me datë 01.11.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimi dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 25.05.2023 është i punësuar në Inspektoratin e Punës në pozitën "Zyrtar i Pranimit dhe Logjistikës", *kategoria profesional 2, koeficienti i pagës I15.*

Kolegji i Këshillit, po ashtu ka konstatuar se ankuesi me datë 18.10.2023 përmes e-mailit ka parashtruar kërkesë në Ministrinë e Punës Brendshme/Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me qëllim të rregullimit të koeficientit ngase në akt emërim kategorinë profesionale e ka të caktuar Profesional 2, ndërsa i njëjti është duke u paguar sipas kategorisë Profesionale 3, kurse për shkak të mosveprimit nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrinë e Punës Brendshme ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit ndërlidhur me at që u konstatue si më lartë dhe lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueseve, ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenin 98 paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj", si dhe nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Ndërlidhur me legjislacionin e potencuar si më lartë, Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës si dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, konstaton se ankesa e ankuesit e datës 26.10.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, ngase e njëjta është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 18.10.2023 ende nuk ka vendosur apo nuk ka nxjerrë akt administrativ përpara se ankuesit të parashtrojnë ankesë në Këshill, sikurse që nuk është përmbushur as kriteri kohor ndërlidhur me heshtjen administrative, pasi që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik sipas dispozitave të lartcekura ligjore ka pasur afat kohor 45 (katërdhjetë e pesë) ditë, për trajtimin e kërkesës së ankuesit të datës 18.10.2023, ndërsa ankuesi ankesën në Këshill e ka parashtruar me datë 26.10.2023 apo 8 (tetë) ditë pas parashtrimin të ankesës në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Andaj, Kolegji për Shqyrtimi de Vendosjen e Ankesave, nga të gjeturat e dhëna si më lartë, konstaton se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 26.10.2023 është parashtruar në kundërshtim me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj është hedhur poshtë si e palejuar si në dispozitiv të këtij vendimi pasi që nuk e plotëson kushtin e nevojshëm të pranueshmërisë së ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1334/2023, datë 06/12/2023

Rushit Kajtazi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetari i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik-MPB
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

